



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria –Vlada-Government**  
**Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit**  
Ministarstvo Obrazovanja, Nauke, Tehnologije i Inovacija  
Ministry of Education, Science, Technology and Innovation

Ministrja e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, në mbështetje të nenit 28 paragrafi 10 dhe 15 të Ligjit nr. 08/L-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës /nr. 13/ 29 Qershor 2023, Prishtinë); nenit 21, paragrafët 1 dhe 2 të Ligjit nr.04/L-037 për Arsimin e Lartë (Gazeta zyrtare nr. 14, datë 09.09.2011), duke u bazuar në nenin 11 (paragrafi 1, nënparagrafi 1.5) të Ligjit nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe nenin 8 (paragrafi 1, nënparagrafi 1.4) të Rregullore QRK-nr. 02/2021 për fushat e përgjegjesisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren QRK-nr. 04/2021 dhe Rregulloren QRK-nr. 03/2022, si dhe në përputhje me nenin 38 (paragrafit 6) të Rregullore së Punës së Qeverisë nr. 09/2011, miraton;

**UDHËZIMI ADMINISTRATIV (MASHTI) UA 01B-03/2024 PËR VLERËSIMIN E PËRSHTATSHMËRISË SË BARTËSVE TË PROGRAMEVE STUDIMORE SI DHE PROGRAMEVE NGA RADHËT E KOMUNITETEVE JO SHUMICË NË PROCESIN E AKREDITIMIT DHE RIAKREDITIMIT TË INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT TË LARTË**

**PJESA I**  
**DISPOZITAT E PËRGJITHËSHME**

**Neni 1**

**Qëllimi dhe fushëveprimi**

1. Qëllimi i këtij Udhëzimi Administrativ është vlerësimi i përshtatshmërisë të bartëseve të programeve studimore, për të cilat IAL aplikojnë në procesin e akreditimit dhe riakreditimit, përfshirë edhe programet studimore nga radhët e komuniteteve jo shumicë si dhe programeve studimore nga fusha e artit/shkencave të aplikuara.
2. Ky udhëzim administrativ zbatohet nga AKA, për të gjitha programet që aplikojnë për akreditim dhe riakreditim, programet e komuniteteve jo shumicë si dhe programeve nga fusha e artit/shkencave të aplikuara.
3. Qëllimi i këtij UA synon të jetësojë vlerat e përcaktuara në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, Ligjin për Arsimin e Lartë dhe Ligjin për Agjencinë e Kosovës për Akreditim.
4. Qëllimi i këtij UA zbatohet duke pasur parasysh Ligjin për Arsimin e Lartë, Ligjin për Agjencinë e Kosovës për Akreditim si dhe standardet e hartuara nga AKA dhe të miratuara nga KSHC.
5. Ky UA për bartësit e programeve aplikohet në proceset e akreditimit dhe riakreditimit të IAL, sipas procedurave të caktuara me standardet e hartuara nga AKA dhe të miratuara nga KSHC.

**Neni 2**

**Shkurtesat dhe përkufizimet**

1. Shkurtesat e përdorura në këtë UA kanë kuptimin si në vijim:

**AKA**-Agjencia e Kosovës për Akreditim

**MASHTI**-Ministria e Arsimit Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit

**IAL**-Institucioni i Arsimit të Lartë

**KSHC**-Këshilli Shtetëror i Cilësisë

**UA**-Udhëzim Administrativ

2. Shkurtesat dhe përkufizimet e përdorura në këtë UA në kuptim të përkufizimeve kanë të njëjtin kuptim sikur në Ligjin për Agjencinë e Kosovës për Akreditim.



3. Për shkurtesat dhe kufizimet të cilat nuk janë të përfshira në këtë UA, vlen Ligji për Agjencinë e Kosovës për Akreditim dhe Ligji për Arsimin e Lartë.

### Neni 3

#### **Kriteret për bartës të programeve studimore**

1. Kriteret për bartës të programeve studimore janë kriteret e përcaktuara me Ligjin për Agjencinë e Kosovës për Akreditim dhe të detajizuara përmes standardeve të hartuara nga AKA dhe të miratuara nga KSHC.
2. Në kuptim të këtij UA, bartësit e programeve nënkuptojnë programet BSc, Ma dhe PhD.
3. Përshtatshmëria e bartësve të programeve studimore, përfshirë ato të komuniteteve jo shumicë dhe programet e fushës së artit/shkencave të aplikuara përcaktohet me këtë UA dhe detajizohet dhe divesifikohet përmes kriterëve të caktuara nga KSHC përmes standardeve të hartuara nga AKA.
4. Kriteret për bartës të programeve BA/BSc, MA/MSc dhe PhD përfshijnë:
  - 4.1. Secili program studimor të ketë (1) bartës për 60 ECTS;
  - 4.2. Secili program studimor duhet të ketë bartës që gradat shkencore dhe thirrjet përkatëse të fituara sipas Ligjit për Arsimin e Lartë ose të barazvlefshme për fushën e artit/shkencave të aplikuara;
  - 4.3. Secili program studimor duhet të ketë bartës të programit me gradat shkencore ose ato ekuivalente për fushën e artit/shkencave të aplikuara dhe të arriturat profesionale në përputhje me profilin shkencor dhe përmbajtjet e veçanta kurrikulave të programit studimor;
  - 4.4. Secili program studimor duhet të ketë bartës të programit me të arriturat profesionale, shkencore dhe artistike si dhe përvojën pedagogjike në përputhje me profilin shkencor përmbajtjet e veçanta kurrikulave të programit studimor;
  - 4.5. Secili bartës i programit duhet të ketë të botuar numrin e kërkuar të publikimeve shkencore, në revistat përkatëse, sipas standardeve të hartuara nga AKA dhe të miratuara nga KSHC ose ekuivalente për programet e fushës së artit;
  - 4.6. Secili bartës i programit duhet të plotësojë kriteret e tjera të caktuara përmes standardeve të hartuara nga AKA dhe të miratuara nga KSHC ose ekuivalente për programet e fushës së artit.
5. Kriteret për bartës të programeve, të përcaktuara në Ligjin për Agjencinë e Kosovës për Akreditim, këtë UA si dhe standardet e hartuara nga AKA dhe të miratuara nga KSHC, aplikohen në të gjitha rastet, si ekuivalente për programet e fushës së artit/shkencave të aplikuara, rast pas rasti dhe vlerësohen si të tilla nga KSHC me rastin e vendimmarrjes dhe vlerësimit.



6. Për bartësit e programeve nga fusha e Mjekësisë, kriteret e përshtatshmërisë caktohen sipas standardeve të hartuara nga AKA dhe të miratuara nga KSHC.
7. Pavarësisht kriterëve për bartës të programeve përcaktuara në Ligjin për Agjencinë e Kosovës për Akreditim, këtë UA si dhe standardet e hartuara nga AKA dhe të miratuara nga KSHC, për programet e komuniteteve jo shumicë, përmes këtij UA caktohen masa afirmative, të cilat mbështeten nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Ligji për Arsimin e Lartë, Ligji për Agjencinë e Kosovës për Akreditim dhe legjislacioni në fuqi për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve jo shumicë në Republikën e Kosovës.

## **PJESA II**

### **VLERËSIMI I PËRSHTATSHMËRISË PËR BARTËSIT E PROGRAMEVE PËR TË GJITHA FUSHAT SHKENCORE SI DHE FUSHËN E ARTIT/SHKENCAVE TË APLIKUARA**

#### **Neni 4**

#### **Numri i ECTS dhe grada shkencore ose grada ekuivalente për fushën e artit/shkencave të aplikuara**

1. Të gjitha IAL që aplikojnë për akreditim dhe riakreditim të programeve studimore, duhet të sigurohen që për çdo 60 ECTS të sigurojnë një bartës të programit që i plotëson kriteret përkatëse sipas ligjit dhe këtij UA.
2. Bartësi i programit duhet të ketë të paktën një diplomë PhD nga fusha e studimit të programit ose profili shkencor i tij ose mbi 50% e përmbajtjes kurrikulare (lëndëve) të programit për të cilin aplikon IAL.
3. Bartësi i programit për fushën e artit/shkencave të aplikuara duhet të ketë diplomë ekuivalente me PhD që përshtatet me profilin shkencor të programit ose mbi 50% e përmbajtjes kurrikulare (lëndëve) të programit për të cilin aplikon IAL.
4. Vlerësimi i përshtatshmërisë së gradës shkencore PhD ose gradës ekuivalente për fushën e artit/shkencave të aplikuara bëhet duke pasur parasysh kodin Erasmus, ndërlidhur me profilin e programit si dhe përshtatshmërinë me rezultatet e të nxënit të programit studimor përkatës, sipas standardeve të AKA.

## Neni 5

### **Të arriturat shkencore, profesionale dhe artistike të bartësit të programit**

1. Me qëllim të vlerësimit të përshtatshmërisë së bartësit të programit, vlerësohet ndërlidhja e të arriturave të tij/saj shkencore dhe artistike, me profilin e programit për të cilin aplikon IAL.
2. Të arriturat profesionale, shkencore dhe artistike me profilin e programit studimor, nënkuptojnë: Publikimet shkencore, të botuara në revistat e caktuara sipas standardeve të hartuara nga AKA dhe të miratuara nga KSHC ose fushën e temës së doktoratës të deklaruar nga AKA apo botimet e tjera të deklaruara në AKA nga bartësi i programit.
3. Të arriturat profesionale, shkencore dhe artistike për programet në fushën e arteve nënkuptojnë punimet ekuivalente, që vlerësojnë të arriturat e kësaj fushe.
4. Për vlerësimin e të arriturave shkencore, profesionale dhe artistike të bartësve të programit, mjafton të plotësohen njëra nga kriteret e përcaktuara në këtë nen dhe nuk ka nevojë që të bëhet plotësimi i tyre në mënyrë komulative.
5. Aplikimin e kriterëve të përshtatshmërisë së bartësit të programit, përfshirë përshtatshmërinë ekuivalente nga fusha e artit/shkencave të aplikuara, e bën KSHC, sipas procedurave të përcaktuara, rast pas rasti, duke vlerësuar ndaras kriteret e përcaktuara në këtë nen.

## Neni 6

### **Përvoja pedagogjike e bartësve të programit**

1. IAL me rastin e aplikimit për bartës të programit, duhet të ketë parasysh edhe përvojën pedagogjike që ka bartësi i programit, ndërlidhur me profilin e programit ose përmbajtjen kurrikulare të tij për të cilën aplikon IAL.
2. KSHC vlerëson përshtatshmërinë e përvojës pedagogjike të bartësve të programit, duke pasur parasysh përvojën e tyre në mësimdhënie për lëndët e fushës përkatëse, ndërlidhur me përmbajtjen e lëndëve të programit studimor për të cilin aplikohet për akreditim dhe riakreditim nga IAL.
3. Me rastin e vlerësimit të përvojës pedagogjike të bartësit të programit, merret parasysh përvoja e tij/saj, në mësimdhënie në IAL-të e akredituara në Republikën e Kosovës, bazuar në vendimet për zgjedhje, emërim dhe riemërim, në gradën përkatëse akademike, të cilat janë deklaruar në AKA, përmes sistemit të e-akreditimit.



## **Neni 7**

### **Aplikimi i kriterëve për bartës të programeve studimore**

1. Kriteret për bartës të programeve studimore të përcaktuara me Ligjin për Agjencinë e Kosovës për Akreditim, këtë UA dhe standardet e miratuara nga AKA dhe të miratuara nga KSHC, aplikohen të ndërlidhura me njëra tjetrën.
2. Në të gjitha rastet, kriteret për bartës të programeve, zbatohen në atë mënyrë që të aplikohet ekuivalenca e kriterit nga fusha e artit/shkencave të aplikuar.
3. Përmes standardeve të hartuar nga AKA dhe të miratuara nga KSHC, mund të detajzohen të gjitha kriteret dhe përcaktimet, të përcaktuara në këtë UA.

## **PJESA III**

### **VLERËSIMI I PËRSHTATSHMËRISË SË BARTËSVE TË PROGRAMIT PËR PROGRAMET E KOMUNITETEVE JO SHUMICË**

## **Neni 8**

### **Programet e studimit të komuniteteve jo shumicë**

1. Republika e Kosovës, bazuar në Ligjin për Arsimin e Lartë, Ligjin për Agjencinë e Kosovës për Akreditim dhe legjislacionin për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve jo shumicë, mbështet shkollimin dhe programet në arsimin e lartë në gjuhët e komuniteteve jo shumicë.
2. MASHTI mbështet standardet e miratuara nga AKA në lidhje me programet dhe bartësit e programeve dhe përmes këtij UA aplikon kriteret të veçanta për bartësit e programeve nga radhët e komuniteteve jo shumicë, me qëllim të mundësimin që në arsimin e lartë të ofrohen programe adekuate, sipas nevojës për të gjitha komunitetet jo shumicë në Republikën e Kosovës.
3. Programet e studimit nga komunitetet jo shumicë, sipas kriterëve të këtij UA kanë parasysh procesin e sigurimit të cilësisë, mundësitë e barabarta për studentët, barazinë para ligjit dhe nevojat e tregut të punës.
4. Programet e studimeve nga radhët e komuniteteve jo shumicë zbatojnë kriteret dhe standardet e përcaktuara nga AKA në lidhje me bartësit e programit, përjashtimisht kriterëve tjera afirmative të përcaktuara në këtë UA për këto programe studimore.

5. Në të gjitha rastet, kriteret afirmative për bartësit e programeve nga radhët e komuniteteve jo shumicë, duhet të shihen si përjashtim, bazuar në garancionet e përcaktuara në Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe legjislacionin përkatës për mbrojtjen dhe promovimin e të drjetave të komuniteteve jo shumicë në Kosovë.

## **Neni 9**

### **Bartësit e programeve studimore të komuniteteve jo shumicë**

1. Programet nga radhët e komuniteteve jo shumicë, duhet të kenë një bartës të emëruar të programit për çdo 60 ECTS, përjashtimisht kur aplikohen masat afirmative sipas këtij UA.
2. Bartësit e programeve nga radhët e komuniteteve jo shumicë, duhet të kenë së paku gradat përkatëse shkencore dhe titujt përkatës shkencor, të fituara sipas Ligjit për Arsimin e Lartë, respektivisht Dr.sc dhe MSc.
3. Gradat shkencore dhe të arriturat profesionale, shkencore dhe artistike si dhe përvoja pedagogjike, të bartësve të programit nga radhët e komuniteteve jo shumicë, duhet të jenë në përputhje me profilin shkencor të programit të studimit ekzistues ose programin për të cilën aplikohet për akreditim, ashtu siç përcaktohet në Ligjin për Agjencinë e Kosovës për Akreditim, këtë UA si dhe standardet e hartuara nga AKA dhe miratuara nga KSHC.
4. Të arriturat profesionale, shkencore dhe artistike si dhe përvoja pedagogjike e bartësve të programit nga radhët e komuniteteve jo shumicë si dhe kriteret e tjera, verifikohen nga KSHC dhe zbatimi i këtyre kriterëve inkurajon programet që kanë të bëjë me promovimin e gjuhës, historisë dhe kulturës së komuniteteve jo shumicë ose plotësimin e nevojave të arsimit të lartë për realizimin e të drejtave të garantuara me legjislacioni në fuqi në Republikën e Kosovës, në fushat përkatëse të jetës publike.
5. Në secilin rast, masat afirmative për bartësit e programeve të komuniteteve jo shumicë, aplikohen vetëm për programet e këtyre komuniteteve dhe nuk mund të zbatohen dhe interpretohen në favor të ndonjë programi tjetër, që nuk i takon komuniteteve jo shumicë, sipas aplikacionit qw dorëzohet nw AKA.
6. AKA merr të gjitha masat teknike dhe administrative, që në rastin e aplikimit për akreditim ose riakreditim, programi përkatës studimor të identifikohet si program që i përket komuniteteve jo shumicë.

## **Neni 10**

### **Masat afirmative për bartësit e programeve të komuniteteve jo shumicë**

1. Masat afirmative për bartësit e programeve nga radhët e komuniteteve jo shumicë zbatohen duke pasur parasysh kriteret ligjore si dhe standardet e AKA, si përjashtim për promovimin



- dhe krijimin e mundësisë për ekzistimin e programeve në arsimin e lartë për komunitetet jo shumicë në arsimin e lartë në Kosovë.
2. Përveç kriterëve të rregullta për bartësit e programit nga radhët e komuniteteve jo shumicë, MASHT zbaton këto masa afirmative:
    - 2.1. Aplikimin për këto programe, pa plotësuar numrin e caktuar të bartësve për çdo 60 ECTS, me kusht që plotësimi i kushteve të bëhet në afat prej 3 viteve;
    - 2.2. Detyrimin që programet e komuniteteve jo shumicë në afatin 3 vjeçar të trajtohen me përparësi sigurimi i kuotave të sigurta të personelit akademik, në rastet kur rrezikohet programi përkatës ekzistues ose programi për të cilin është aplikuar për akreditim ose riakreditim;
    - 2.3. Krijimin e mundësisë që për një periudhë 3 vjeçare, për programet komuniteteve jo shumicë, të nivelit Ma, të ketë mundësi që të shfrytëzohet i njëjti bartës, sikur në programin Ba;
    - 2.4. Krijimin e mundësisë që për të paktën 3 vite bartës i programit në programin e komuniteteve jo shumicë, të jenë edhe personeli akademik, i cili është bartës në një program tjetër;
    - 2.5. Krijimin e mundësisë që bartës i programit në programet e komuniteteve jo shumicë, më së shumti një bartës, si përjashtim të ketë gradën akademike asistent;
    - 2.6. Krijimin e mundësisë që bartësit e programeve nga radhët e komuniteteve jo shumicë, për një periudhë 3 vjeçare nga momenti i aplikimit të jenë bartëse edhe në programet e tjera të IAL.
  3. Masat afirmative të përcaktuara në këtë nen, mund të aplikohen vetëm si përjashtim, me kushtin që në afat prej 3 viteve, nga momenti i aplikimit për program të ri ose për riakreditim.
  4. Në rast se IAL nuk mund të plotësojë kriteret për bartës të programeve nga radhët e komuniteteve jo shumicë, brenda një viti, pas aplikimit të masave afirmative, atëherë nuk mund të regjistrojë student për vitin përkatës në programin nga radhët e komuniteteve jo shumicë, deri në plotësimin e kushtit për bartës të programit, në vitin pasues.
  5. Me rastin e aplikimit për akreditim dhe riakreditim për programet e komuniteteve jo shumicë, mund të aplikohet secila masë afirmative e përshtatshme, bazuar në mundësitë që ka IAL.
  6. Përveç masave afirmative të përcaktuara në këtë nen, bartësit e programeve nga radhët e komuniteteve jo shumicë, duhet të plotësojnë të gjitha kriteret e tjera të përcaktuara me Ligjin për Agjencinë e Kosovës për Akreditim, këtë UA si dhe standardet e hartuara nga AKA dhe të miratuara nga KSHC.



## **Neni 11**

### **Aplikimi për programet e reja të komuniteteve jo shumicë**

1. Aplikimi për programet e reja nga radhët e komuniteteve jo shumicë bëhet duke pasur parasysh masat afirmative të përcaktuara me këtë UA.
2. IAL, pas aplikimit për programet e reja, në rast të rrezikimit të programit nga radhët e komuniteteve jo shumicë, obligohet që në afat sa më të shpejtë të përcjell kërkesën për sigurimin e kuotës për personel akademik, për të siguruar bartësit adekuat të programit, duke zbatuar procedurat e konkursit publik me prioritet.
3. MASHTI, në bashkëpunim me institucionet tjera kompetente, obligohet që të realizojë kërkesën për sigurimin e kuotës për personel akademik për programet e komuniteteve jo shumicë, kur të njëjtit rrezikohen për shkak të bartësve. Kërkesa përfshinë nevojat minimale për mbulimin financiar të numrit të bartësve që nevojiten për programin studimor. Kërkesa me pasqyrimin e nevojave, sipas këtij neni i drejtohet MASHTI-it ngë Këshilli Drejtues i IAL, në rastin kur programi financohet nga buxheti i Republikës së Kosovës.

## **Neni 12**

### **Trajtimi i programeve ekzistuese të komuniteteve jo shumicë**

1. Të gjitha programet ekzistuese të akredituara të komuniteteve jo shumicë, që nuk i plotësojnë kushtet për përshtatshmërinë e programeve nga radhët e komuniteteve jo shumicë, trajtohen duke marrë parasysh masat afirmative, nëse ato janë të zbatueshme, në afat prej 3 viteve.
2. Në rast se programet ekzistuese të komuniteteve jo shumicë, nuk i plotësojnë kushtet as me rastin e aplikimit të masave afirmative, atëherë aplikohen dispozitat kalimtare të këtij UA.

## **Neni 13**

### **Dispozitat kalimtare**

1. Në rast se programet studimore, përfshirë edhe ato të fushës së artit/shkencave të aplikuara, në mungesë të UA për përcaktimin e përshtatshmërisë së bartësve, nuk kanë mundur të aplikojnë për riakreditim të programeve aktuale, i vazhdohet akreditimi edhe për një periudhë 3 vjeçare, respektivisht deri në periudhën e ardhme të aplikimit, në vitin pasues pas hyrjes në fuqi të këtij UA. Aplikimi pas kalimit të kësaj periudhe për këto programe bëhet, sipas standardeve të reja të hartuara nga AKA dhe të miratuara nga KSHC.

2. Në rast se programet ekzistuese të komuniteteve jo shumicë, nuk i plotësojnë kriteret e vlerësimit të përshtatshmërisë për bartës të programit, përfshirë edhe kriteret afirmative sipas këtij UA, programi studimor respektiv akreditohet më të njëjtat kushte edhe për një (1) vit, respektivisht deri në vitin pasus, pas hyrjes në fuqi të këtij UA. Pas kalimit të kësaj periudhe, programet ekzistuese, zbatojnë kriteret dhe standardet e hartuara nga AKA dhe të miratuara nga KSHC, duke aplikuar masat afirmative që kanë të bëjnë sigurimin e kuotave kur rrezikohet programi për shkak të barteësve, sipas nenit 10 paragrafi 2.2 i këtij UA.

#### **Neni 14**

#### **Dispozitat shfuqizuese**

Me hyrjen në fuqi të këtij Udhëzimi Administrativ shfuqizohet Udhëzimi Administrativ shfuqizohet UA 2015/18 i MASHT.

#### **Neni 15**

#### **Hyrja në fuqi**

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare.

  
Arbërie Nagavci  
  
Ministre/ MASHTI

Dt: 25.07 2024